

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NUOVA ALBA” SH.P.K

Ortakët themelues:

- **Z. Davide Manfredini**, shtetas italian, i datëlindjes 10/03/1959, lindur në Poggio Renatico, Ferrara, banues në Rrugën Del Bove, nr. 88/A, Ferrara, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YB6105953 dhe
- **Zj. Barbara Cantori**, shtetase italiane, e datëlindjes 03/11/1967, lindur në Cento, Ferrara, banuese në Rrugën Rigone, nr. 3/1, Ferrara, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës italiane Nr. YC2567899

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 12.01.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**NUOVA ALBA**” SH.P.K Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “**NUOVA ALBA**” SH.P.K ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**NUOVA ALBA**” SH.P.K, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqiperi.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Aktivitet në fushën e pasurive të patundshme, vlerësimin e pasurive të patundshme, të angazhohet në shitjen me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie dhe të hapë dyqane, dege apo zyra përfaqësimi brënda dhe jashtë territorit shqiptar po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Manaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Investime në fushën e ndërtimit dhe tregtimit brënda dhe jashtë vendit të pasurive të paluajtshme. Administrimin e bashkëpronësise në ndërtesa brënda

Barbara Cantori *Davide Manfredini*

dhe jashtë vendit. Ndërmjetësimi për shitje blerje apo dhënie me qera të pronave të paluajtshme midis personave fizikë, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe cdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme. Dhënie me qera, nënqera të ambjenteve të ndryshme, si dhe cdo veprimtari tjetër e cila i shërben përmbushjes së qëllimit të shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Veprimtari në fushën e konsulencës teknike për të gjitha fushat e ekonomisë, agrokulture apo kryerje studimesh komplekse për degë të ndryshme. Shit-blerje dhe dhënie me qera, leasing, të pajisjeve të ndryshme në fushën agrare dhe industriale. Kryerje studimesh ekonomike-financiare, konsulencë variable dhe administrative.

NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "NUOVA ALBA" SH.P.K mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brënda dhe jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "NUOVA ALBA" SH.P.K. Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar në vlerën e aksioneve që ata kanë kontribuar në shoqëri.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "NUOVA ALBA" SH.P.K është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët e ndarë në 2 pjesë:

Z. Davide Manfredini – 1 kuotë – 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë)
dhe

Zj. Barbara Cantori – 1 kuotë – 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë)

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga dy administratorë që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Administratorët e shoqërisë do të jenë **Z. Davide Manfredini dhe Zj. Barbara Cantori.**

Barbara Cantori *Davide Manfredini*

NENI 11
Sekreti tregtar


Ortakët, administratoret dhe punëmarrësit e shoqërisë “NUOVA ALBA” SH.P.K përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12
Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Davide Manfredini



Barbara Cantori

